



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
MINISTRI

URDHËR

NR. 124, 12.05. 2015

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARREVESHJEVE
HIDROKARBURE.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit Nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, VKM nr. 335, datë 22.04.2015 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 279, datë 12.04.2012, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria “Albpetrol” sh.a)” dhe për zbatimin e synimit themelor për thithjen e investimeve të huaja, apo vendase, në fushën e kërkimit të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për blloqet e Lira Kërkimit, si dhe për të garantuar zhvillimin e një procedure të hapur, konkurruese,

URDHËROJ:

1. AKBN të publikojë, menjëherë, në faqen e saj të internetit hartën e blloqeve të lira të kërkimit në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe formularin e aplikimit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit për blloqet 4, 5 dhe Dumre, i cili duhet të jetë deri më datën 15.06.2015.
2. Dokumentacioni që do të publikohet të dërgohet në mënyrë zyrtare në MEI dhe një kopje e tij të dërgohet në adresën elektronike të saj. MEI të publikojë në faqen e saj të internetit këtë dokumentacion.
3. Në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të “Rregulloren për procedurat e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure dhe licence marrëveshjeve, si dhe afatet përkatëse”, e ndryshuar, në AKBN të ngrihet grupi negociator për Termat dhe Kushtet Kryesore të Marrëveshjes Hidrokarbure, të mundshme për t’u lidhur. Përfaqësues i MEI në këtë grup, do të jete z. Ilia Gjermani.

4. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen AKBN, si dhe Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve në MEI.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI